



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.914/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “IPKO Telecommunications” L.L.C, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit D.M. zyrtar ligjor tek kreditori, kundër debitorit Komuna e Skenderajt, të cilin e përfaqëson E.Q. avokat publik, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve ndërgjyqëse, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Skenderaj – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.57/2019 të datës 24.02.2020, me datën 21.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHEN si të themelta ankesa e kreditorit “IPKO Telekommunications” L.L.C, me seli në Prishtinë dhe ankesa e debitorit Komuna e Skenderajt, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.57/2019 i datës 24.02.2020, dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.57/2019 të datës 24.02.2020, ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin debitorit “IPKO Telecommunications” L.L.C, me seli në Prishtinë të datës 07.03.2019, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit PPP.nr.443/2019 i datës 22.02.2019, ashtu që Shfuqizohet pjesërisht urdhri mbi lejimin e përmbarimit PPP.nr.443/2019 i datës 22.02.2019, për periudhën prej vitit 2013 deri me datë 01.05.2015 në shumën prej 6,508.08€, ngase ky borxh është parashkruar, dhe obligohet debitori që kreditorit t’i paguaj borxhin për shpenzimet e ofruara të telefonisë mobile sipas kontratës të lidhur me datë 01.05.2015 deri më 30.04.2018 në shumën prej 10,066.88€ me kamatën ligjore në normë prej 8% nga data e marrjes së vendimit deri në pagesën definitive.

Kundër këtij aktvendimi, ne afatin ligjor, kanë paraqitur ankesë të dyja palët ndërgjyqëse:

- Kreditori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të LPP-së dhe LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e kreditorit të miratohet si e bazuar, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë Dega Skenderaj PPP.nr.57/2019 i datës 24.02.2020 të Ndryshohet ashtu që prapësimi i debitorit Komuna e Skenderaj të refuzohet si i pabazuar, ndërkaq që Urdhri për lejimin e Propozimit për Përmbarrim të Zyrës Përmbarrimore P.nr.443/2019 të datës 22.02.2019 të mbetet në fuqi.
- Debitori, për shkak se një kërkesë e tillë është parashkruar – vjetërsuar duke u bazuar në dispozitat ligjore të LMD-së, përkatësisht të nenit 360 par 1 e nën par 1.3 i cili nen është normë speciale sepse flet ekskluzivisht për përdorimin e telefonit, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Skenderajt, të prishet Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Dega Skenderaj PPP.nr.57/2019 i datës 24.02.2020 dhe çështjen ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
- Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori me propozim që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet propozimi për përmbarrim kreditorit “IPKO Telekomunikations” L.L.C, me seli në Prishtinë, dhe të refuzohet propozimi për përmbarrim i kreditorit “IPKO Telekomunikations” L.L.C, me seli në Prishtinë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

-Ankesat e kreditorit dhe debitorit janë të themelta.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “IPKO Telekommunikations” L.L.C, me, me seli në Prishtinë, me datën 22.02.2019, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit Komuna e Skenderajt, lidhur me pagesën e borxhit në emër të shërbimeve të ofruara të telefonisë mobile sipas faturave të pranuar nga debitori me pretendimin se debitori në vazhdimësi i ka ofruar shërbimet sipas kontratave të lidhura, dhe për këto shërbime debitori nuk e ka përmbush detyrimin në lartësinë prej 16,574.96€. Përmbarruesi Privat Vais Law nga Prishtina, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.443/19 dt.22.02.2019, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga faturat t’i paguaj shumën prej 16,574.96€ me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e skadimit të pagesës për secilën faturë e deri në pagesën definitive të borxhit si dhe detyrohet debitori t’i paguaj shpenzimet e procedurës përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Kundër urdhrit përbarimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se faturave të cilave iu ka referuar kreditori të viteve 2012, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, janë përfshi me dispozitat e parashkrimit, me LMD-në, përkatësisht me nenin 360 par 1 nën par 1.3 dhe paragrafi 3 i këtij neni. Përveç parashkrimit, nga ana e kreditorit nuk janë sjell me vite faturat nga kreditori tek debitori për pagesë, pra u shkel neni 2.5 i Kontratës së Lidhur në mes të Operatorit IPKO dhe Komunës së Skenderajt. Po ashtu shumat kanë qenë të limituara për zyrtarët e komunës, ndërsa IPKO ka lejuar që të shpenzohet më shumë se sa shuma e lejuar, më ç'rast barra e përgjegjësisë bie mbi Operatorin Ipko e jo mbi Komunën për shpenzimet më të larta se sa ato të lejuara.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, pas vlerësimit të prapësimin dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.57/2019 dt.24.02.2020, me të cilin e ka Aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës ka vlerësuar se lejimi i përbarimit është i bazuar në ligj pikërisht në dispozitat e nenit 29 par.1 nën paragrafi 1.3, nenit 37 dhe 38 para.1 dhe 2 të LPP-së ngase është i pamohueshëm fakti se debitori me datë 19.05.2015 ka lidhur kontratë me kreditorin që të marr shërbime të telefonisë mobile dhe t'i paguaj këto shërbime, dhe se faturat për shërbime i ka pranuar në mënyrë të rregullt por nuk iu ka përmbajtur kontratës për pagesën e detyrimit. Sipas dispozitave ligjore të përmendura më lartë, lejimi i përbarimit është bërë në bazë të dokumentit të besueshëm dhe të përshtatshëm për përbarim. Gjykata ka gjet se propozimi për përbarim është pjesërisht i bazuar ngase pjesa e borxhit prej 6,508.08€ është e periudhës kohore para datës 19.05.2015, ndaj ky borxh është i vjetërsuar sipas dispozitave të nenit 355 të LMD-së ku rregullohen kërkesat reciproke nga kontratat komerciale ku në paragrafin 1 shprehimisht thuhet "Kërkesa reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shërbimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata parashkruhen për tri vite". Në rastin konkret debitori është i obliguar që kreditorit për shpenzimet e telefonisë mobile që i ka krijuar nga data 19.05.2015 deri 30.05.2018 t'i paguaj shumën prej 10,066.88€ që dëshmohet nga faturat në shkresat e lëndës, sepse gjatë kësaj periudhë në mënyrë të rregullt i ka pranuar faturat për shërbimet e ofruara dhe se kohë pas kohe ka bërë pagesa që shifet se ka bërë zvogëlimin e borxhit.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 355 të LMD.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e atakuar i cili përmban të meta në kuptim të ndërtimit të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, duke qenë i pa kuptueshëm dhe i pa ekzekutueshëm, në kundërshtim me arsyetimin e aktvendimit dhe në kundërtënie me palët në procedurën përbarimore. Sipas propozimit për përbarim datës

22.02.2019 dhe Urdhrit përmbartimor PPP.nr.443/2019 i datës 22.02.2019 i lejuar nga përmbartuesi privat Vais Law në Prishtinë, palë në këtë çështje përmbartimore janë kreditori “IPKO Telekommunications” L.L.C, me seli në Prishtinë, dhe debitor Komuna e Skënderaj, ndërsa në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar në pjesën I të dispozitivit, Aprovon pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit IPKO Telekommunications” L.L.C, me seli në Prishtinë. Prandaj si i tillë ky aktvendim është i përfshire me shkelje të dispozitës së nenit 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, që parasheh: *në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;*

Dhomat e shkallës së dytë vëren nga shkresat e lëndës, se Propozimit për përmbartim kreditori ka bashkangjitur si titull përmbartimor dhe dokument të besueshëm Marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, e lidhur mes palëve ndërgjyqëse, faturat e kreditorit nga të cilat kjo gjykatë tani për tani nuk ka mund të vërtetoj pretendimet lidhur me përshtatshmërinë dhe besueshmërinë e këtyre faturave për tu konsideruar si dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.3 e LPP-së. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë një konstatim të saktë në aspektin e gjendjes faktike lidhur me pretendimet e debitorit se faturat nuk janë dorëzuar rregullisht nga kreditori tek debitori, i cili është fakt vendimtar për tu konsideruar se fatura i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar si dokument i besueshëm.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe nuk janë vërtetuar të gjitha faktet sa i përket pretendimeve të kreditorit se nuk është zbatuar neni 368 par.1 i LMD-së, sepse debitori kishte paguar pjesërisht detyrimet e tij të borxhit ndaj kreditorit deri me datën 30.05.2018.

Në ri procedurë, Dhoma e shkallës së parë e Gjykatës Komerciale, duhet të ketë parasysh të gjeturat e lartcekura, të vlerëson në mënyrë të drejtë se a janë plotësuar kushtet ligjore se faturat bashkangjitura propozimit për përmbartim nga kreditori, janë dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për tu realizuar përmbartimi, nga dispozitat e nenit 27 dhe 29 të LPP-së, të vlerësoj pretendimet e palëve ndërgjyqëse, sa i përket kërkesës ligjore në parashkrim apo ndërprerje të borxhit, në vështirim të nenit 355, 368 të LMD-së, eventualisht të caktohet seancë dëgjimore sipas rrethanave që vlerëson Dhoma e shkallës së parë, e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.914/23, me datë 21.02.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha